



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2905/5 prot.

Datë 05.12.2023

V E N D I M
Nr. 1254/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.12.2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-88148-11-17-2023, me objekt “Blerje Kompjutera dhe Projektor”, me fond limit: 2,054,475.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 11.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastër.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

“Blueprint Technologies” SHPK me NIPT L82428011G dhe adresë: Njësia Administrative nr. 10, Rruga “Fortuzi”, Nr.66/1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastër, me adresë: Lagjja “18 Shtatori” Gjirokastër.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,

Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.11.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-88148-11-17-2023, me objekt “Blerje Kompjuterë dhe Projektor”, me fond limit: 2,054,475.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 11.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastër.

II.2. Në datën 22.11.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3635, protokolluar me nr. 2905/2023 prot., datë 22.11.2023, e operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, konkretisht duke pretenduar:

“- Ne piken 2.2.2 kerkohet:

Operatoret ekonomike duhet te paraqesin bilancet vjetore, per vitet financiare 2020-2021-2022, te shoqeruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetem ne rastin kur jane ne kushtet e percaktimeve te nenit 41, pika c, te ligjit nr.10091 date 5.3.2009 Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar i ndryshuar, ku bilancet e dy viteteve te njepasnjeshme, nuk duhet te kene raport negativ ndermjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kerkesa eshte ne kundërshtim me LPP dhe VKM per percaktimin e RPP. Konkretisht VKM 285 dt 19.05.2021, neni 55 percakton se kerkesa ekonomike financiare konsiderohen te plotesuara me vertetimin e xhiros.

Per sa me siper, kjo kerkese duhet te hiqet

2- Ne piken 2.3.6 kerkohet:

Kerkohen te paraqiten mostra per te gjithë artikujt e ofruar.

Kerkesa per moster per artikullin Projektor Tipi 1, i cili eshte vetem 1 cope ne prokurim, nuk eshte e mbështetur ne ligj, nuk eshte ne perputhje me madhesine dhe llojin e kontrates, dhe nuk i sherben AK ne procesin e prokurimit. Gjithashtu Paisjet kompjuterike kane katalogje teknike shume te qarta, te verifikueshme lehtesisht si nga katalogu qe OE mund te dorezoje, ashtu edhe ne websitin e prodhuesit. Kerkesa per moster fizike eshte e tepert dhe nuk i sherben procesit. Per sa me siper, kerkojme heqjen e kerkeses per moster, dhe zevendesimin e saj me kerkesen per katalogje teknike nga prodhuesi i pajisjes

3- AFATI I LEVRIMIT AK ka parashikuar per kete procedure nje afat levrimit prej 3 ditesh. Afati prej 3 ditesh eshte i pamjaftueshem dhe i pa bazuar ne ligj, duke patur parasysh madhesine e kontrates, si dhe duke marre ne konsiderate qe mallrat objekt - prokurimi nuk jane mallra te karakterit emergjent, por jane paisje qe do t'i sherbejne AK per nje kohe te gjate, duke qene pjese e Aktiveve Afatgjata te AK Si te tilla, kerkojme vendosjen ne dispozicion te nje kohe 15 ditore, si nje kohe minimale e nevojshme per realizimin e nje kontrate publike

4- Specifikimet teknike te pa plota per Kompjuter Desktop 1

Ne specifikimet teknike per Desktop 1, mungon elementi kryesor, procesori. AK nuk ka percaktuar asnje parameter minimal qe duhet te plotesoje procesori i njesise kompjuterike. Per te shmangur keqkuptimet dhe vonesat ne realizimin e kontrates, si dhe duke qene se procesori eshte elementi i pare i specifikuar ne te gjitha manuallet e AKSHI-t, kerkojme nga ana juaj percaktimin e specifikimeve minimale teknike qe duhet te plotesoje procesori i njesive te kerkuara.”

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të

plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën nr. 989/8 datë 24.11.2023 është depozituar në KPP informacioni i autoritetit kontraktor për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, i cili e ka pranuar pjesërisht atë, si më poshtë vijon:

“[...]1. Lidhur me pikën 2.2.2 “Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilanci vjetore, për vitet financiare 2020-2021-2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Aftorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika ”c”, të ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, ku bilanci e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit... ” hiqet nga KVK

.....

4 Lidhur me specifikimet teknike të paplota për Kompjuter Desktop 1, më poshtë po vendosim specifikimet për elementin procesor: KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net: 7900 Pikë”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Me shkresën nr. 989/8 datë 24.11.2023, është depozituar në KPP informacioni i autoritetit kontraktor për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, i cili e ka pranuar pjesërisht atë, si më poshtë vijon:

“[...]1. Lidhur me pikën 2.2.2 “Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilanci vjetore, për vitet financiare 2020-2021-2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Aftorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika ”c”, të ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, ku bilanci e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit... ” hiqet nga KVK

.....

4 Lidhur me specifikimet teknike të paplota për Kompjuter Desktop 1 më poshtë po vendosim specifikimet për elementin procesor: KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net: 7900 Pikë”

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se : Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

III.1.4. Sa më sipër, referuar nenit 115, të Ligjit Nr. nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik vendos të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK dhe do të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pretendimet e tjera të paraqitura në ankesë.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Blueprint Technologies” SHPK për pikën 2.3.6 të dokumenteve të tenderit, lidhur me paraqitjen e mostrave për të cilën kërkon:

“Heqjen e kërkesës për mostër dhe zëvendësimin e saj me katalogje teknike nga prodhuesi i pajisjes.” KPP vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit “Kapaciteti teknik” pika 2.3.6, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

”Kërkohen të paraqiten mostra për të gjithë artikujt e ofruar. Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë Spitalit Rajonal Gjirokaster, të mbyllura me ngjitëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit **“Blerje Kompjuterë dhe Projektor dhe jo para datës 01.12.2023 ora 11:00.”**”

III.2.2 Në shtojcën nr. 5 të dokumenteve të tenderit “Formulari i specifikimeve teknike” autoriteti kontraktor ka parashikuar:

Specifikime Kompjuterë

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
“RAM”:	8 GB DDR4, min. 2666 MHz, Non-ECC
Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size”:	500 GB SSD
“Disk Subsystem Controller”:	Serial ATA III 6 Gb/s
Karta Grafike “Graphics”:	Integrated graphic Card, min. 1 GB
“Media Device”:	DVD+/-RW
“Slots	”: Min. (3) PCI/PCI-E, ngatëcilat min. (1) PCI-E 3.0 x16
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (6) USB ngatëcilat:
	a. Min. (2) USB Para; b. Min. (4) USB 3.0
	(1) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone,
	(1) Portë DP/DVI/HDMI/VGA

Rrjeti "Networking":	(1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port
"Sound":	Integrated Sound Card
"Speakers":	Internal or Built-in Monitor
Siguria "Security Management":	Embedded Security TPM 2.0
Sistemii Operimit "Preinstalled Licensed O. S.":	OEM Windows 10 64-bit Professional
Tastiera "Keyboard":	Standart Keyboard QWERTY
"Mouse":	Minimum 3 Button Scroll Optical
Ushqimi	"Power Supply" 220 V AC, 50 Hz
Kursimii Energjisë "Energy Efficiency":	Energy Star
AKSESORËT	
Kabëll "Power Cord":	Po, European
"Recover":	Recover Partition
MONITORI	
Tipi "Type":	LCD OSE LED itënjëjtës Markë me Kompjuterin
Madhësia "Size":	≥ 21"
Rezolucioni "Native Resolution":	1920 x 1080 at 60 Hz
Raportii Kontratit "Contrast Ratio Static":	1000:1
"Display Port":	(1) VGA dhetëpaktën (1) prej portave DP/DVI/HDMI
Koha e Rifreskimit "Response Time":	≤ 6 ms
Kursimii Energjisë "Energy Efficiency":	Energy Star
Ushqimi "Power Supply":	220 V AC, 50 Hz
GARANCIA	

Periudha e MbulimitëGarancisë “Warranty”:	3 Vjet
---	--------

Specifikime Projektor

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Tipi “Type”:	<i>DLP ose LCD oseEkuivalente</i>
Ndriçimi “Brightness” :	<i>3000 ANSI Lumen</i>
Rezolucioni “Resolution”:	<i>WXGA 1280 x 800</i>
Përputhshmëria Video “Video Compatibility”:	<i>NTSC/PAL</i>
Jetëgjatësia e Llampës "Lamp Life":	<i>6000 Orë, Standard</i>
RaportiiKontrastit “Contrast Ratio”:	<i>5 000 : 1</i>
RregullimiiLenteve “Lens Adjusting”:	<i>F Number, Zoom Manual, Focus Manual</i>
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
PortatHyrëse “Input Terminal”:	<i>(1) VGA, (1) HDMI, (1) USB</i>
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	<i>European</i>
Telekomandë “Remote Control”:	<i>Po</i>
KabujtëPërfshirë "Included Cords":	<i>(1) VGA – VGA, (1) HDMI – HDMI; Kabujtduhettëkenëgjatësi min. 3 m</i>
CD Manual Përdoruesi "CD User Manual":	<i>Po</i>
Çanta “Carrying Bag”:	<i>Po</i>
GARANCIA	
Periudha e MbulimitëGarancisë “Warranty”:	2 Vjet

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

III.2.3 . Në nenin 77 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.2.5. Neni 40, pika 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se :

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.6. Në nenin 40 pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kriterë fituese për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë, se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim

kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

III.2.8. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues të paraqitura në ankesë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kërkesa për paraqitjen e mostrave për secilin prej artikujve të kërkuar nga autoriteti kontraktor është në proporcion me objektin e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertuese zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. KPP konstaton, se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kriterë kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kriterë të tjera kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimit të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave. Në këto kushte, KPP gjykon se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e mostrave është në përputhje me nenin 40, pika 6 gërma “a” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, si dhe është një kërkesë në përputhje me objektin e prokurimit, si dhe me volumin dhe përmasat e kontratës dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit, por autoriteti kontraktor me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së një numri sa më të gjerë operatorësh në procedurën e prokurimit dhe stimulimin e konkurrencës mes operatorëve ekonomikë, duhet të lërë të hapur mundësinë e verifikimit të plotësimit të specifikimeve teknike përmes mostrave ose alternativave të tjera që parashikon legjislacioni i prokurimit publik, pasi vetë ligjvënësi në nenin 40 pika 6 të *lex specialis* ka lënë të hapur mundësinë, që rast pas rasti kur natyra dhe përmasat e kontratës e lejojnë autoritetin kontraktor, në mënyrë të justifikuar të mund të kërkojë paraqitjen e mostrave ose katalogëve/skedave teknike me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së plotë të specifikimeve teknike të artikujve me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, se: “*kërkojmë vendosjen në dispozicion të një kohe 15 ditore si një kohë minimale e nevojshme për realizimin e një kontrate publike*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 6 “Formulari i sasisë dhe grafiku i lëvrimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi përcaktohet si më poshtë:

Shtojca 6

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Afatet e lëvrimit:

<i>Artikulli</i>	<i>Përshkrimi</i>	<i>Shuma</i>	<i>Destinacioni</i>	<i>Periudha e dorëzimit</i>
<i>1</i>	<i>Kompjutera Desktop 1</i>	<i>15</i>	<i>SRGJ</i>	<i>3 dite nga nënshkrimi i kontrates</i>
<i>2</i>	<i>Projektor Tipi 1</i>	<i>1</i>	<i>SRGJ</i>	<i>3 dite nga nënshkrimi i kontrates</i>

III.2.2. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikon se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.2.3. Neni 3 Parime të përgjithshme *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III 2.4. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor *1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në*

zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi

III.2.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

III.2.6. Në rastin konkret, KPP referuar pretendimit të ankimuesit, si dhe argumenteve të autoritetit kontraktor gjykon, se periudha e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi nuk është e mjaftueshme për realizimin në kohë dhe me cilësi të objektit të prokurimit, duke patur parasysh sasinë e mallit që do të lëvrohet, volumit të kontratës dhe shpërndarjes së tyre. Ndaj KPP gjykon, se afati i lëvrimin të mallit në rastin konkret duhet të jetë më i gjatë në përputhje me volumin dhe përmasat e kontratës, në mënyrë që ofertuesve t'ju lihet koha e nevojshme për të siguruar në kohë mallin me karakteristikat dhe specifikimet e kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Për rrjedhojë autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e afatit të lëvrimin të mallit, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit “Blueprint Technologies” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të

Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-88148-11-17-2023, me objekt “Blerje Kompjuterë dhe Projektor”, me fond limit: 2,054,475.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 11.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastër.
 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK në procedurën e sipërcituar të prokurimit.
 3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Blueprint Technologies” SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

